



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË**

Korçë, më datë 19/10/2021

Proces-verbal nr. 1

Bazuar në ligjin nr 139/ 2015, neni 3, pika “dh”, në datën 13 tetor 2021 në kuadrin e procesit të “Buxhetimit me Pjesëmarrje”, për të diskutuar lidhur me kërkesa dhe shqetësime të banorëve, u zhvillua takimi me banorët e qytetit të Bashkisë Korçë.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin z. Sotiraq Filo Kryetar Bashkia Korçë, z. Kletjon Kita Zv.Kryetar Bashkia Korçë, Ilir Dinellari Drejtor i NSHP, Leonard Gjançi Dr. i Menaxhimit të Kontratave, Soniel Prifti Drejtor i drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.

Fjalën e mori i pari z. Sotiraq Filo, i cili listoi disa nga investimet e mëdha të realizuara dhe në proces në qytetin e Korçës. Mes tyre përmendi projektin e rivitalizimit të lulishtes “Vangjush Mio”, e cila përmes investimit të kryer ofron një ambient me më shumë hapësira të gjelbra dhe një vend të përshtatshëm për të gjitha moshat. Gjithashtu, asfaltimi i rrugëve në lagje të ndryshme të qytetit ishte një tjetër premtim i mbajtur. Një rëndësi të veçantë i është kushtuar familjeve në nevojë, për të cilat është kryer restaurimi i banesave ekzistuese. Është realizuar ndërtimi i terrenit sportiv në lagjen 17 që ishte një kërkesë e vetë banorëve. Në vazhdim ai foli edhe për rëndësinë e marrjes së mendimeve të qytetarëve dhe vendosjen e prioriteteve për investimet pasi impakti i parë i çdo projekti perceptohet prej tyre.

Pasi u njohën me shpjegimet përkatëse për “Buxhetimin me Pjesëmarrje”, qytetarët e Korçës patën hapësirën e nevojshme kohore për të ngritur kërkesat e tyre dhe për të vendosur prioritetet sa i takon fokusit të investimeve të Bashkisë Korçë për vitin 2022. Kërkesat e tyre u mbajtën shënim paralelisht dhe të detajuara. Bazuar në kërkesat e ngritura nga qytetarët u listuan prioritetet si më poshtë:

1. Sistemim i ambienteve brenda lagjeve të banimit
2. Shtim i koshave për hedhjen e mbeturinave
3. Sistemim i kanalizimeve për ujrën e zezat në lagjen 3
4. Disiplinim i bizneseve për mirëmbajtjen e ambientit përreth

Përvëç ndërhyrjeve në infrastrukturë ku banorë të së njëjtës lagje mbështesnin kërkesat e njëri-tjetrit, u sollën edhe sugjerime për projekte në aspektin social.

XXX: Banor, lagjja 8, ish NPV-ja.: Në Korçë është punuar dhe për këtë jemi të gjithë të vetëdijshëm, investime janë bërë dhe po bëhen, Korça është një qytet që ka turizëm në çdo periudhë të vitit. Ankesa ime është për bizneset e ndërtimit që operojnë në lagjen tonë. E ndotin jashtë mase zonën, ndaj jam i mendimit që pastrimi i qytetit në atë zonë të bëhet rreth orës 17:00-18:00, kur mbyll aktivitetin dhe pronari i biznesit, është e kotë që të bëhet më parë. Problem tjetër janë kartonat, bizneset nuk i thyejnë dhe t’i hedhin në vendet e grumbullimit të plehrave por i lënë të hapura në mes të rrugës, duke dhënë kështu një imazh të keq për qytetin. Shpresojmë për një zgjidhje të kësaj situate, sepse është në të mirë të turizmit dhe të banorëve që jetojnë aty.

XXX: Banor, lagjja 3, rruga “Tefta Tashko Koço”: Kërkojmë zgjidhje për kanalizimin e ujërave të zeza. Po afron dimri dhe gjatë kësaj stine çdo gjë bëhet më e vështirë. Është një problem që na shqetëson të gjithëve ndaj duam zgjidhje sa më të shpejt, se siç e thashë po afron dimri dhe çdo gjë pastaj vjen në përkeqësim të të gjithë banorëve të zonës.

XXX: Banore, pallati i Gjergji Skllavit: Nuk po ju përcaktoj as emër lagjeje as emër rruge sepse realisht nuk ka, ndaj dhe pyetja e parë që shtroj unë është, a ka një plan urbanistik për rrugën që ska as emër? Një problem tjetër është pastrimi i rrugës, kam vite që banoj në atë pallat dhe shumë pak herë kam parë makinat të

vijnë për pastrim, ose punëtorët. Më duket si një rrugë e përjashtuar nga pjesa tjetër e qytetit. Kazani i mbeturinave problem, a mund të ketë më shumë në numër në atë zonë ju lutem sepse vijnë dhe nga lagje të tjera dhe i hedhin mbeturinat aty. Unë e kam kazanin afër dritares, nuk mund të duroj erën e plehrave, kazanët mbushen plot sa dhe shumica i lenë plehrat në asfalt. Ngjitur me hotel “Alysan” është hapur një biznes dërstili, ai punon pa rregull. Gjithë materialet e tij na vijnë brenda në shtëpi, është e patolerueshme. Kërkojmë një investim për trotuaret, domethënë kjo rrugë ka problem sepse duhet sistemuar dhe konturuar. Në pallatin tonë është edhe parkimi problem, s’kemi ku parkojmë makinat tona pasi poshtë pallatit parkojnë edhe makina të tonazhit të rëndë, kjo nuk është fare normale. Nuk e di çfarë zgjidhje do i jepni, mbase të vendosni një table për t’i parandaluar, ose një mënyrë tjetër. Ish-godina e trikotazhit është kthyer në një ambient aspak të përshtatshëm për jetesën në komunitet, duhet të merren masa sa më shpejt që të jetë e mundur. Nëse është pronë private të komunikoni ju me pronarët, të paktën t’i bëjnë një rrethim ambientit, fjala juaj vlen më shumë. Këto janë problemet që na shqetësojnë ne, ju falenderoj që na bëni pjesë të këtyre takimeve, shpresojmë sa më shpejt në një zgjidhje.

XXX: Banor lagjja 10, rruga “Koço Kondili: Unë do të ngre disa probleme në fakt. E para dhe më e rëndësishmja investimet në atë zonë ku banoj unë janë të pakta, po flas për zonën përballë shkollës së Maltës. Problem tjetër janë qentë e rrugës, duhet të merrni masa sipas mënyrës që ju keni gjetur për këtë problem, në këtë zonë realisht janë shumë problem. Për pjesën e banesavë të strehimit, me vjen keq të them se kontigjenti që sillni aty nuk është ai i duhuri, sërish po e lë në dorën tuaj zgjidhjen e këtij problemi.

XXX: Banore, lagjja 14: Kryetar, përveç atyre që duhen bërë akoma në Korçë unë ju falenderoj shumë për asfaltimin e rrugës në lagjen 14. Faleminderit ju dhe gjithë stafit që kanë punuar, puna që është bërë aty është më të vërtët për t’u lavdëruar.

Konceptoi

Lorena Saro

**Drejtoare e Marrëdhënieve me Publikun
dhe Informimin Qytetar**

Larisa Katundi